



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs*

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**  
**Nr. 14/2009 -MPB**  
**PËR REGJISTRIMIN E AUTOMJETEVE**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION**  
**No. 14/2009 – MIA**  
**ON VEHICLE REGISTRATION**

**ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA**  
**Br. 14/2009 - MUP**



<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b> <b>Qeveria</b> <b>Ministria e Punëve të Brendshme</b></p> <p>Ministri i Punëve të Brendshme</p> <p>Në mbështetje të nenit 301 dhe 303.4. të Ligjit Për Sigurinë Në Komunikacionin Rrugor, Ligji Nr. 02/L-70 dhe të nenit 25(7) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nxjerr :</p> <p style="text-align: center;"><b>Udhëzim Administrativ</b> <b>Nr.14/2009</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Për Regjistrimin e Automjeteve</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b></p> <p>Me këtë Udhëzim përcaktohen kushtet dhe mënyrat e regjistrimit të mjeteve motorike dhe mjeteve bashkëngjitëse që përfshin: regjistrimin e parë, vazhdimin e regjistrimit, transferimin dhe ç'lajmërimin e mjeteve motorike dhe tërheqëse, në tekstin e mëtejshëm: automjetet. Përcaktohet përmbajtja dhe dimensionet e librezës së qarkullimit, targave të regjistrimit, mënyra e udhëheqjes së evidencës për automjetet e regjistruara dhe përmbajtja e programit</p>	<p style="text-align: center;"><b>Republik of Kosovo</b> <b>Government</b> <b>Ministry of Internal Affairs</b></p> <p>The Minister of Internal Affairs</p> <p>Pursuant to Article 301 and 303.4. Law on Road Traffic Safety, Law No. 02/L-70 and the article 25(7) on Regulation On the Work the Government the Republic of Kosovo, issues :</p> <p style="text-align: center;"><b>Administrative Instruction</b> <b>No. 14/2009</b></p> <p style="text-align: center;"><b>on Registration of Vehicles</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1</b></p> <p>By this Instruction are determined the conditions and manners of registration of motorist means and attaching means: first registrations, extension of registration, transfer and de-registration of motorist and drawing means, in further text: vehicles. It is assigned the content and dimensions of the traffic book, registration plates, manner of keeping the evidence for registered vehicles and content of the computer program.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Republika Kosovo</b> <b>Vlada</b> <b>Ministarstvo Unutrašnjih Poslova</b></p> <p>Ministar Unutrašnjih Poslova</p> <p>Na osnovu člana 301 i 303.4. Zakona o Bezbednosti Saobraćaja na Putevima, Zakon BR.02/L-70, i člana 25(7) Pravilnika o Radu Vlade Republike Kosova, donosi :</p> <p style="text-align: center;"><b>Administrativno Uputstvo</b> <b>Br. 14/2009</b></p> <p style="text-align: center;"><b>O Registraciji Motornih Vozila</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1</b></p> <p>Ovim Uputstvom utvrđuju se uslovi i način registracije motornih vozila i priključnih vozila: prva registracija, produžetak registracije, prenos i odjava motornih i vučnih vozila, u daljem tekstu: motorna vozila. Utvrđuje se sadržaj i dimenzije saobraćajne dozvole, registarskih tablica, način vođenja evidencije o registrovanim motornim vozilima i sadržaj kompjuterskog programa.</p>
---	---	--



<p>kompjuterik.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b></p> <p>Regjistrimin e automjeteve e bën Ministria e Punëve të Brendshme në tekstin e mëtejshëm: MPB, Departamenti për Regjistrimin e Automjeteve dhe Patentë Shoferëve, në tekstin e mëtejshëm: DRAPSH, gjegjësisht Qendra Komunale e Regjistrimit të Automjeteve, në tekstin e mëtejshëm: QKRA-ja, në bazë të vendbanimit të pronarit apo vendqëndrimit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b></p> <p>1. Për të gjitha llojet e regjistrimit sipas Nenit 7 të këtij Udhëzimi Administrativ, me përjashtim të pikës 11 të nenit 7, aplikohet forma unike, shiko formulari Nr. 1.</p> <p>2. QKRA-ja bën regjistrimin e automjeteve nëse pronari i automjetit paraqet:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>2.1 Dëshminë mbi pronësinë e automjetit;</li><li>2.2 Faturën e prodhuesit – shitësit të automjetit;</li><li>2.3 Dokumentin origjinal të shtetit përkatës;</li></ul>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2</b></p> <p>The registration of vehicles is conducted by the Ministry of Internal Affairs, in the further text: MIA, Department on Vehicle Registration and Driving Licence in further text: DVRDL, respectively the Municipality Centre for Vehicle Registration, in further text: MCVR, in the basis of the residence of the owner, or his emplacement.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3</b></p> <p>1. For all types of registration according to article 7 of this Administrative Instruction, exception point 11 article 7, it is applied the unique form, see form No. 1.</p> <p>2. MCVR conducts the registration of the vehicles if the owner of the vehicle present:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>2.1 Proofs of the ownership on vehicle;</li><li>2.2 Receipt of the producer – seller of the vehicle;</li><li>2.3 Original document of the respective state;</li></ul>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2</b></p> <p>Registraciju motornih vozila vrši Ministarstvo unutrašnjih poslova, u daljem tekstu: MUP, Department za Registraciju Vozila i Vozačke Dozvole, u daljem tekstu: DRVVD, odnosno Opštinski Centar za Registraciju Vozila, u daljem tekstu: OCRV, na osnovu mesta prebivališta vlasnika ili mesta boravka.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3</b></p> <p>1. Za sve vrste registracije u skladu sa članom 7 ovog Administrativnog uputstva, sa izuzetkom tačke 11 člana 7, podnosi se jedinstveni obrazac, pogledaj obrazac br. 1.</p> <p>2. OCRV vrši registraciju motornih vozila ukoliko vlasnik motornog vozila podnese:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>2.1 Dokaz o vlasništvu nad motornim vozilom;</li><li>2.2 Fakturu proizvođača – prodavca motornog vozila;</li><li>2.3 Originalan dokument iz odnosne države;</li></ul>
--	--	--



<p>2.4 Dokumentin e identifikimit të lëshuar nga organet e Kosovës;</p> <p>2.5 Polisën e sigurimit;</p> <p>2.6 Dokumentin Unik Doganor, në tekstin e mëtejshëm: DUD-in në raste të veçanta edhe Vendimi Doganor;</p> <p>2.7 Dëshminë mbi pagesën e taksës të përcaktuar me Vendimin mbi Tarifat;</p> <p>2.8 Dëshminë mbi pagesën e taksës rrugore për automjetin;</p> <p>2.9 Certifikatën e kontrollimit teknik të automjetit të lëshuar nga subjekti i licencuar nga organi kompetent;</p> <p>2.10 Nëse janë disa bashkëpronar të automjetit, automjeti regjistrohet në emër të njërit bashkëpronar me një deklaratë me shkrim prej bashkëpronarëve të tjerë, të vërtetuar nga organi kompetent;</p> <p>2.11 Kërkesën për regjistrim të automjetit e paraqet pronari i automjetit ose personi i autorizuar me autorizim të vërtetuar në gjykatë;</p> <p>2.12 Automjetet në pronësi të personave juridik dhe fizik</p>	<p>2.4 Identification document issued by the bodies of Kosovo;</p> <p>2.5 Insurance policy;</p> <p>2.6 Unique Customs Document, in further text: UCD in special cases also the Custom Decision;</p> <p>2.7 Proofs for payment taxes according to the Decision on Taxes;</p> <p>2.8 Proofs for payment road taxes for Vehicles</p> <p>2.9 Certificate of the technical control of the vehicle issued by the licensed subject by the competent body;</p> <p>2.10 If there are more co-owners of the vehicle, the vehicle is registered in behalf of one co-owner with a written statement from other co-owners certified by the competent body;</p> <p>2.11 The request for registration of vehicle is presented by the owner of the vehicle or person authorised with an authorisation certified at the court;</p> <p>2.12 Vehicles in the ownership of legal and physical persons</p>	<p>2.4 Ispravu izdatu od strane kosovskih organa;</p> <p>2.5 Polisu osiguranja;</p> <p>2.6 Jedinstveni carinski dokument, u daljem tekstu: JCD i u posebnim slučajevima i carinsko rešenje;</p> <p>2.7 Dokaz o uplati takse predviđene Rešenje Administrativne Takse;</p> <p>2.8 Dokaz o uplati putne takse za motorna vozila;</p> <p>2.9 Potvrdu o tehničkom pregledu motornog vozila izdatu od strane subjekata koji imaju dozvolu za obavljanje ove delatnosti od strane nadležnog organa.</p> <p>2.10 Ukoliko su nekoliko suvlasnika motornih vozila, motorno vozilo se registruje pod imenom jednog suvlasnika izjavom drugih suvlasnika u pismenoj formi overenom od strane nadležnog organa.</p> <p>2.11 Zahtev za registraciju motornog vozila podnosi se od strane vlasnika vozila ili ovlašćenog lica na osnovu overenog sudskog punomoćja.</p> <p>2.12 Motorna vozila u vlasništvu pravnih i fizičkih lica registruju se</p>
--	---	---



<p>regjistrohen në bazë të vendbanimit, vendqëndrimit dhe kjo dëshmohet në bazë të dokumentit të identifikimit.</p> <p>2.13 Dëshmi mbi pagesën e taksës komunale për automjetin.</p> <p>3. Nëse pala nuk posedon dokumentin nga pikat 1,2 dhe 3 të Paragrafit 2 të Nenit 3, mund të prezantoj fotokopjen e dokumentit të vërtetuar nga shteti përkatës ose dokument tjetër original i cili prezanton mjaftueshëm të dhënat e automjetit në fjalë.</p> <p>4. Për mjetin e punës - traktor, për të cilët pala nuk posedon dokument sipas pikave 1, 2 dhe 3 të paragrafit 2 të nenit 3 të këtij Udhëzimi Administrativ, të cilët kanë ekzistuar në Kosovë para 10 qershorit 1999, pala mund t'a regjistroj traktorin me deklaratën e dy dëshmitarëve të vërtetuar në Gjykatë.</p> <p>5. Për automjetet e regjistruara në Kosovë para 10 qershorit 1999 mund të bëhet reregjistrimi. Për këtë kategori të automjeteve përpos dokumenteve nga pika 1 e paragrafit 2 të nenit 3, nevojiten këto dokumente:</p>	<p>are registered in the basis of the residence, emplacement and this is proved in the basis of identification document.</p> <p>2.13 Proofs on municipality taxes payment of the Vehicles.</p> <p>3. If the party does not possess the document from items 1, 2 and 3 of paragraph 2 of Article 3, it may present the photocopy of the certified document from the respective state or other original document which sufficiently presents data on the vehicle in question.</p> <p>4. For the working mean - tractor, for which the party does not possess a document according to items 1, 2 and 3 of paragraph 2 of Article 3 of this Administrative Instruction, which has existed in Kosovo before 10 June 1999, the party may register the tractor, with statements of two witnesses, certified at the Court.</p> <p>5. For the vehicles registered in Kosovo before 10 June 1999, it can be done the re-registering. For this category of vehicles except documents from item 1 of paragraph 2 of Article 3, are needed these documents:</p>	<p>na osnovu mesta prebivališta, mesta boravka i isto se dokazuje putem ličnih isprava.</p> <p>2.13 Dokaz o uplati opštinskog takse za motorna vozita.</p> <p>3. Ukoliko stranka ne poseduje dokumentaciju iz tačkaka 1, 2 i 3 stava 2 člana 3, može dati na uvid fotokopiju dokumenta overenog od strane odnosne države odnosno drugi originalan dokumenat koji u dovoljnoj meri predstavlja podatke datog motornog vozi</p> <p>4. Vozilo – traktor, za koji stranka ne poseduje isprave prema tačkama 1, 2 i 3 stava 2, člana 3 ovog Administrativnog Upustva, koji su bili primenjivi na Kosovu pre 10.juna 1999, stranka može da registruje traktor sa izjavom dva svedoka utvrđena od strane suda.</p> <p>5. Za motorna vozila registrovana na Kosovu pre 10. juna 1999. može se izvršiti preregistracija. Za ovu kategoriju motornih vozila, pored dokumentacije iz tačke 1 Stava 2 člana 3, potrebna su i sledeća dokumenta:</p>
--	--	---



<p>5.1 Dokumenti mbi Regjistrimin e Automjetit, në tekstin e mëtejme: DRA-ja , nga regjistrimi i fundit;</p> <p>5.2 Në rastet kur mungon DRA-ja, për çfarëdo arsye atëherë nevojitet kopja e vërtetuar e dosjes e cila lëshohet nga organi kompetent i ngarkuar me arkivat të cilat i përmbajnë këto lëndë –DRAPSH.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b></p>	<p>5.1 The Document on Vehicle Registration, in further text: DVR, from the last registration;</p> <p>5.2 In cases when the DVR is missing, for any reason, then it is needed the certified copy of the dossier which is issued by competent body in charge for archives which contains these files –DVRDL</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b></p>	<p>5.1 Dokumentat o registraciji vozila, u daljem tekstu: DRV, od poslednje registracije;</p> <p>5.2 U slučajevima kada nedostaje DRV iz bilo kog razloga, potrebna je i overena kopija dosijea koji se izdaje od strane nadležnog organa odgovornog za arhive koje sadrže ove predmete –DRVVD.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b></p>
<p>Regjistrimi i Automjeteve të përfaqësive diplomatike e konsullore, misioneve të shteteve të huaja, përfaqësive të organizatave ndërkombëtare në Republikën e Kosovës dhe personelit të tyre, rregullohet me akt të veçantë nënligjor nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b></p> <p>1. Shtetasit e huaj, ndërmarrjet tregtare të huaja, përfaqësuesit e përhershëm zyrtar në përfaqësitë e huaja tregtare, kulturore dhe sportive, kërkesës për regjistrim të automjetit i bashkangjesin këto dokumente:</p>	<p>The Registration of Vehicles of the diplomatic and consular representation, foreign states missions, representations of international organization in Republic of Kosovo and their personnel, regulated by a special sub-legal act by the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b></p> <p>1. Foreign citizens, foreign trade enterprises, permanent official representatives of the foreign trade, cultural and sport representations, to the request for vehicle registration are attaching these documents:</p>	<p>Registracija motornih vozila diplomatskih i konzularnih predstavništava, misija stranih država, predstavništava međunarodnih organizacija u Republiku Kosovo i njihovog osoblja, regulisati sa posebnim podzakonskim aktom Ministarstva Spoljnih Poslova Republike Kosova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b></p> <p>1. Strani državljani, strana trgovinska preduzeća, stalni službeni predstavnici u stranim trgovinskim, kulturnim i sportskim predstavništvima, prilažu sledeća dokumenta zahtevu za registraciju motornog vozila:</p>



<p>1.1 Dokumentin personal për të huajin;</p> <p>1.2 Dokumentin nëpërmjet të cilit tregohet se të huajit i është lejuar qëndrimi i përhershëm apo i përkohshëm në Kosovë;</p> <p>1.3 Vendimin nga Dogana për miratimin e importit të përkohshëm të automjetit;</p> <p>1.4 Certifikata e biznesit nëse janë të regjistruara në Kosovë dhe</p> <p>1.5 Kontrata për punë</p> <p>2. Për automjetet e shtetasve të huaj të cilëve iu është lejuar qëndrimi i përkohshëm në Kosovë, DRA-ja i lëshohet me afat deri me datën e lejes së qëndrimit, gjegjësisht në kohën sa është i lejuar përkohësisht importi i mjetit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b></p> <p>1. Automjeti regjistrohet në emër të pronarit të automjetit. Për automjetin e regjistruar lëshohet DRA- ja dhe targat e regjistrimit.</p> <p>2. Me rastin e regjistrimit të motoçikletave, makinave të punës dhe mjeteve</p>	<p>1.1 Personal document of the foreigner;</p> <p>1.2 Document through which is shown that to the foreigner is permitted permanent or temporary residence in Kosovo;</p> <p>1.3 Decision from the Customs for approval of temporary import of the vehicle;</p> <p>1.4 Business certificate if they are registered in Kosovo and</p> <p>1.5 Contract on labour.</p> <p>2. For the vehicles of foreign citizens to whom is permitted the temporary stay in Kosovo, DVR is issued in timeframe until the date of the stay permission, respectively in timeframe for which it is temporarily permitted the import of the vehicle.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b></p> <p>1. The vehicle is registered in the name of the owner of vehicle. For the registered vehicle is provided the Traffic Book and Registration Plates.</p> <p>2. In case of registration of motorcycles, working machines and attaching means, it</p>	<p>1.1 lične isprave stranca;</p> <p>1.2 dokumenat kojim se pokazuje da je strancu dozvoljen stalan ili privremeni boravak na Kosovu;</p> <p>1.3 Carinsko rešenje kojim se dozvoljava privremeni uvoz motornog vozila;</p> <p>1.4 potvrda o registraciji preduzeća, ukoliko su registrovani na Kosovu i</p> <p>1.5 Ugovor o radnom odnosu</p> <p>2. Za motorna vozila stranih državljana kojima je data dozvola za privremeni boravak na Kosovu, DRV izdaje se na rok važenja do datuma naznačenog na boravišnoj dozvoli, odnosno na vreme na koje je privremeno dozvoljen uvoz vozila.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b></p> <p>1. Motorno vozilo registruje se na ime vlasnika motornog vozila. Za registrovano motorno vozilo, izdaje se saobraćajna dozvola i registarske tablice.</p> <p>2. U slučajevima registracije motocikala, radnih mašina i priključnih vozila izdaje se</p>
--	--	---



<p>bashkangjitime lëshohet vetëm një targë.</p> <p>3. Nëse pronari i automjetit është shoqatë lizingu, në librezën e qarkullimit shënohet pronari i automjetit ndërsa në rubrikën vërejtje shënohet edhe shfrytëzuesi i automjetit lizing.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b></p> <p>1. Gjatë procesit të Regjistrimit të Automjetit përfshihen këto lloje të regjistrimit:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1 Regjistrimi i parë;</li><li>1.2 Vazhdimi i regjistrimit;</li><li>1.3 Ç'lajmrimi i automjetit;</li><li>1.4 Ndërrimi i pronarit;</li><li>1.5 Humbja e DRA-së dhe dëmtimi;</li><li>1.6 Humbja e tabelave të regjistrimit dhe dëmtimi;</li><li>1.7 Riregjistrimi;</li><li>1.8 Legalizimi;</li><li>1.9 Targat provuese;</li><li>1.10 Targat e përkohshme;</li><li>1.11 Transferimi i lëndëve;</li><li>1.12 Regjistrimi i përkohshëm.</li></ul>	<p>is issued only one plate.</p> <p>3. If the owner of the vehicle is leasing association, in the traffic book is noted the owner of the vehicle while in the remark's box is noted also the user of the leasing vehicle.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b></p> <p>1. During the process of Vehicle Registration are included these types of registration:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1 First registration;</li><li>1.2 Extension of registration;</li><li>1.3 De-registration of vehicle;</li><li>1.4 Change of owner;</li><li>1.5 Loss of DVR and damage;</li><li>1.6 Loss of registration plates and damage;</li><li>1.7 Re-registration;</li><li>1.8 Legalisation;</li><li>1.9 Probation plates;</li><li>1.10 Temporary plates;</li><li>1.11 Transfer of subjects;</li><li>1.12 Temporary registration.</li></ul>	<p>samo jedna registarska tablica.</p> <p>3. Ukoliko vlasnik motornog vozila jeste društvo za iznajmljivanje vozila, u saobraćajnu dozvolu upisuje se vlasnik motornog vozila a u rubrici za napomene navodi se i korisnik motornog vozila koje se iznajmljuje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7</b></p> <p>1. Tokom procesa registracije motornih vozila predviđene su sledeće vrste registracije:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1 Prva registracija;</li><li>1.2 Produžetak registracije;</li><li>1.3 Odjava motornog vozila;</li><li>1.4 Promena vlasnika;</li><li>1.5 Gubitak DRV-a i oštećivanje;</li><li>1.6 Gubitak registarskih tablica i oštećivanje;</li><li>1.7 Lonovna registracija;</li><li>1.8 Legalizacija;</li><li>1.9 Probne tablice;</li><li>1.10 Privremene tablice;</li><li>1.11 Prenos predmeta;</li><li>1.12 Privremena registracija.</li></ul>
---	--	---





<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b></p> <p>1. Për regjistrimin e parë kërkohen dokumentet të parapara në Nenin 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>2. Në rast të dyshimit në dokumentacionin e përmendur sipas Neni 3 të këtij Udhëzimi Administrativ, DRAPSH njofton organet e hetuesisë për verifikim.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b></p> <p>1. For the first registration are required the documents foreseen in Article 3 of this Administrative Instruction.</p> <p>2. In case of doubt of the documentation mentioned according to Article 3 of this Administrative Instruction, DVRDL the competent body informs the investigation bodies for verification.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b></p> <p>1. Za prvu dokumentaciju potrebna su dokumenta predviđena članom 3 ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>2. U slučaju sumnje u pomenutu dokumentaciju u skladu sa članom 3 ovog Administrativnog uputstva, DRVVD nadležan organ obaveštava istražne organe u cilju provere.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b></p> <p>1. Dokumentacioni i nevojshëm për vazhdimin e regjistrimit është:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1 DRA- ja;</li><li>1.2 Certifikata e rregullsisë teknike e automjetit;</li><li>1.3 Polisa e sigurimit dhe dëshmia e pagesës në bankë;</li><li>1.4 Prezentimi i dokumentit të identifikimit të pronarit;</li><li>1.5 Dëshmia mbi pagesat e taksave të parapara.</li></ul> <p>2. Kërkesa për vazhdimin e regjistrimit mund të bëhet maksimalisht një muaj para kalimit të afatit të regjistrimit të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b></p> <p>1. Documentation needed for the extension of registration is:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1 VRD;</li><li>1.2 Certificate of technical regularity;</li><li>1.3 Insurance policy and proof of bank payment;</li><li>1.4 Presentation of identification document of the owner;</li><li>1.5 Proof on payment of foreseen taxes.</li></ul> <p>2. The request for extension of registration may be conducted in maximum one month before the expiry of the previous</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b></p> <p>1. Potrebna dokumentacija za produžetak registracije uključuje:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1 DRV;</li><li>1.2 Potvrdu o tehničkoj ispravnosti;</li><li>1.3 Polisu osiguranja i dokaz o bankovnoj uplati;</li><li>1.4 Davanje na uvid ličnih isprava vlasnika;</li><li>1.5 Dokaz o uplati predviđenih taksi.</li></ul> <p>2. Zahtev za produžetak registracije može se podneti najviše mesec dana pre isteka roka važnosti prethodne registracije.</p>



<p>mëparshëm.</p> <p>3. Pronari i automjetit është i detyruar të bëjë vazhdimin e regjistrimit të automjetit nga data e skadimit të afatit të regjistrimit.</p> <p>4. Pas kalimit të afatit një muaj nga data e skadimit të regjistrimit të automjetit, pronari i automjetit është i detyruar të paguaj dyfishin e taksës administrative.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b></p> <p>1. Pronari i automjetit të regjistruar mund të bëjë ç'lajmrimin e automjetit.</p> <p>2. Për ç'lajmërim të automjetit nevojitet:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1 Dorëzimi i targave të regjistrimit në QKRA;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2 Kërkesa për ç'lajmërim të automjetit;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3 Prezentimi i DRA-së.</p> <p>3. DRA e lajmëruar, në origjinal i kthehet palës, ku evidentohet data e ç'lajmërimit.</p> <p>4. Pala ka të drejtë të bëjë ç'lajmrimin një</p>	<p>registration deadline.</p> <p>3. Ovner of vehicles is obligate for the extension of vehicles registration from the date of expery registration.</p> <p>4. From the expery time of one month from the expery date of vehicles registration, ovner of vehicles obligate to peiment duble price of administrative taks.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b></p> <p>1. The owner of the registered vehicle may conduct the de-registration of vehicle.</p> <p>2. On de-registration of vehicle needed:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1 Handing over of the registration plates in the MCVR;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2 Request for de-registration of vehicle;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3 DVR registered.</p> <p>3. DVR registered in original is returned to the party, where it is evidenced the date and the de-registration.</p> <p>4. The party has the right to do the de-</p>	<p>3. Vlasnik vozila mora da produži registraciju vozila od date završetka roka registracije.</p> <p>4. Posle isteka roka od mesec dana od dana isteka datum registracije vozila, vlasnik vozila je obavezan da plati dvostruku administrativne takse.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b></p> <p>1. Vlasnik motornog vozila može odjaviti vozilo.</p> <p>2. Za odjavu motornog vozila treba:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1 Podnošenje registarskih tablica OCRV-u;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2 Zahtev za odjavu motornog vozila;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3 Prijavljena DRV-a;</p> <p>3. DRV prijavljenog vozila vraća se stranki, i evidentira se datum odjava.</p> <p>4. Stranka ima pravo da izvrši odjavu jedan</p>
---	---	--



<p>muaj pas skadimit të afatit të vazhdimet. Ç'lajmërimi i automjetit bëhet në bazën e të dhënave.</p> <p>5. Pala është e obliguar ta bëjë ç'lajmërimin e automjetit në këto raste :</p> <p>5.1 Nëse e ndërron vendbanimin apo vendqëndrimin dhe shpërngulet prej një komune në komunën tjetër, e ndërron vendin e regjistrimit.</p> <p>5.2 Nëse e shet automjetin jashtë territorit të qendrës së regjistrimit ku ka qenë i regjistruar me parë, pronari i automjetit me parë duhet ta ç'lajmëroj automjetin dhe t'i kthej tabelat.</p> <p>5.3 Nëse automjeti është vjedhur, duhet të sjell raportin e policisë si dëshmi për ç'lajmërim.</p> <p>5.4 Në rastin e amortizimit, dëmtimit, aksidentit dhe daljes së automjetit jashtë funksionit për çfarëdo arsye, bëhet ç'lajmërimi dhe kthimi i targave me kërkesën e palës.</p> <p>6. Pas skadimit të vlefshmërisë së regjistrimit dhe të afatit një muaj, nëse</p>	<p>registration one month before the expiry of the timeframe for extension. In the database is conducted the de-registration of the vehicle.</p> <p>5. The party is obliged to conduct the de-registration of vehicle in these cases:</p> <p>5.1 If it changes the residence or emplacement and displaces from one municipality to other, changes the registration place.</p> <p>5.2 If it sells the vehicle outside of the territory of registration centre where it was registered before, the owner of the vehicle firstly should de-register the vehicle and hand over the plates.</p> <p>5.3 If the vehicle is stolen, it should bring the police report as proof for de-registration.</p> <p>5.4 In the case of amortisation, damage, accident and for any reason the vehicle comes out of order, it is conducted the de-registration and return of plates on request of the party.</p> <p>6. After the expiry of the validity of registration and one month deadline,</p>	<p>mesec nakon isteka roka važnosti. Odjava motornog vozila vrši se u bazi podataka.</p> <p>5. Stranka je obavezna da izvrši ispis motornog vozila u sledećim slučajevima:</p> <p>5.1 Ukoliko promeni mesto prebivališta ili mesto boravka i ukoliko se preseli iz jedne opštine u drugu, menja mesto registracije.</p> <p>5.2 Ukoliko proda vozilo van teritorije centra za registraciju pri kome je prethodno registrovan, vlasnik vozila prethodno treba da odjavi motorno vozilo i da vrati tablice.</p> <p>5.3 Ukoliko je vozilo ukradeno, treba da donese policijsku prijavu kao dokaz za ispis.</p> <p>5.4 U slučaju amortizacije, dotrajalosti, oštećenosti nesreće ili prekida funkcije motornog vozila iz bilo kog razloga, vrši se odjava i vraćanje tablica na zahtev stranke.</p> <p>6. Nakon isteka roka važnosti registracije i jednomesečnog roka, ako ova motorna</p>
---	--	--



<p>këto automjete nuk regjistrohen, atherë do të kalojnë në automjete pasive në bazën e të dhënave mbi regjistrimin e automjeteve.</p>	<p>these vehicles will pass to passive vehicles in the database of registration of vehicles.</p>	<p>vozila nisu registrovane onda prelaze u pasivna vozila u bazi podataka o registraciji vozila.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b></p>
<p>1. Në rastin e humbjes apo vjedhjes së DRA-së ose targave të regjistrimit pronari apo përdoruesi i automjetit duhet të lajmëroj stacionin policor më të afërt. Policia pas lajmërimit të rastit, duhet ti lëshoj dokumentin për humbjen apo vjedhjen e DRA-së ose targave, sipas pohimit të lajmëruesit.</p>	<p>1. In case of loss or theft of the DVR or plates registration the owner or user of the vehicle should inform the nearest police station. The police, after being notified about the case, should issue a document on loss or theft of DRV according to the allegations of the informer.</p>	<p>1. U slučaju gubitka ili krađe DRV-a ili registarske tablice vlasnik ili korisnik vozila treba da obavesti o istom najbližu policijsku stanicu. Policija nakon prijavljanja slučaja, treba da izda dokumenat o gubitku ili krađi DRV-a u skladu sa tvrdnjama lica koje je prijavilo dati slučaj.</p>
<p>2. Ky dokument duhet ti përmbaj të dhënat e mjaftueshme për pronarin, automjetin, DRA-në ose targat.</p>	<p>2. This document should contain sufficient information about the owner, vehicle and DVR or plates.</p>	<p>2. Ovaj dokumenat treba da sadrži dovoljne podatke o vlasniku, vozilu i DRV ili tablice.</p>
<p>3. Në rastin e dëmtimit të DRA-së, ose targave, pala duhet që DRA-në e dëmtuar ose targat t'ia prezantoj QKRA-së dhe më pas ai e merr DRA-në e re ose targat, të cilën e paguan sipas Vendimit mbi Tarifat, ndërsa DRA e dëmtuar ose targat arkivohen.</p>	<p>3. In the case of damage of DVR or plates the party should present the damaged DVR or plates to the CVR and afterwards he receives a new DRV or plates, which he pays according to the Decision on Tariffs, while the damaged DVR or plates is archived.</p>	<p>3. U slučaju oštećivanja DRV-a, ili tablice stranka treba da da na uvid oštećeni DRV ili tablice i nakon toga uzima novi DRV, koji plaća shodno Odluci o Tarifama, dok se oštećeni DRV arhivira.</p>
<p>4. Ndërrimi i DRA-së ose targave bëhet sipas kërkesës me shkrim.</p>	<p>4. Replacement of the DVR is preceded by the written request.</p>	<p>4. Promeni DRV-a vrši se pismeni zahtev.</p>



<b>Neni 12</b>	<b>Article 12</b>	<b>Član 12</b>
<p>1. Në rastin kur automjeti është i ç'lajmëruar dhe kërkohet nga pala të regjistrohet përsëri, nevojiten këto dokumente :</p> <p>1.1 DRA e ç'lajmëruar;</p> <p>1.2 Kontrollimi teknik;</p> <p>1.3 Polica e sigurimit dhe dëshmia mbi pagesën;</p> <p>1.4 Pagesat e taksave administrative, sipas Vendimit mbi Tarifat;</p> <p>1.5 Në rast të ndërrimit të pronarit kërkohet kontrata e shitblerjes, kontrata mbi dhuratën, akti i trashëgimisë, dokumenti me anën e të cilit është fituar pronësia.</p> <p>2. Palës, e cila i paraqet dokumentet sipas paragrafit 1 i jipen targat e reja dhe DRA-ja e re, ndërsa DRA-ja e vjetër mbetet në arkiv.</p> <p>3. Automjetet që shiten në ankand publik të cilat më parë janë konfiskuar nga organet kompetente mund të reregjistrohen me vendim ekzekutiv të Gjykatës, vendimin e organeve të ndjekjes, si dhe aktin e</p>	<p>1. In the case when the vehicle is de-registered and it is requested from the party to again register, these documents are needed:</p> <p>1.1 De-registered DVR;</p> <p>1.2 Technical control;</p> <p>1.3 Insurance policy and proof of payment;</p> <p>1.4 Payment of administrative taxes according to the Decision on Tariffs;</p> <p>1.5 In the case of the change of owner it is requested the purchasing contract, contract on gift, inheritance act, document through which is gained the ownership.</p> <p>2. To the party which presents the documents according to paragraph 1, are given the new plates and new DVR while the old DVR remains in archive.</p> <p>3. Vehicles which are sold in public auction which were earlier confiscated by the competent bodies may be re-registered with the executive decision of the Court, decision of prosecution bodies, and with</p>	<p>1. U slučaju kada je motorno vozilo odjavljeno i kada se od stranke zahteva da bude ponovo registrovan, potrebna su sledeća dokumenta:</p> <p>1.1 Odjavljeni DRV;</p> <p>1.2 Tehnički pregled;</p> <p>1.3 Polisa osiguranja i dokaz o isplati;</p> <p>1.4 Uplata administrativnih taksi, u skladu sa Odlukom o Tarifama;</p> <p>1.5 U slučaju promene vlasnika zahteva se ugovor o kupoprodaji, ugovor o poklonu, akt o nasleđu, dokumenat kojim je dobijeno vlasništvo.</p> <p>2. Stranka koja podnese dokumenta u skladu sa stavom 1 ovog člana dobija nove tablice i novi DRV a stari DRV ostaje u arhivi.</p> <p>3. Vozila koja se prodaju na javnoj aukciji a koja su prethodno konfiskovana od strane nadležni organa mogu se ponovo registrovati na osnovu izvršne sudske odluke, odlukom organa krivičnog gonjenja</p>



<p>shitblerjes të Shërbimit Doganor të Kosovës. Në këto raste transaksioni i ndryshimit të pronësisë bartet tek blerësi - fituesi në ankand i cili më parë duhet të kryej obligimet sipas Paragrafit 1 të këtij Neni.</p> <p>4. Për automjetet që më parë janë ç'lajmëruar dhe duhet të bëhet bartja e pronësisë, edhe nëse blerësi i takon një komunë tjetër, mund të reregjistrohen në QKRA-në, në bazë të vendbanimit ose vendqëndrimit të qytetarit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b></p> <p>Automjetet të cilat për një arsye apo tjetër janë regjistruar në mënyrë jo të rregullt i nënshtrohen procesit të legalizimit, pas përfundimit të procedurave administrative dhe ligjore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b></p> <p>1. Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase qytetarëve u mundësohet transferim i lëndëve sipas vendbanimit.</p>	<p>the purchasing act of Kosovo Customs Service. In these cases the transaction of change of ownership is transferred to the purchaser – winner in auction, who should firstly fulfil the obligations according to Paragraph 1 of this article.</p> <p>4. For the vehicles which were previously de-registered and should conduct the transfer of ownership, even the purchaser belong to other municipality should firstly be re-registered in the existing MCVR and afterwards be transferred in the MCVR based on the citizens' residence.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 13</b></p> <p>Vehicles which, for one or other reason, are registered in not-proper manner are subjected to the process of legalisation, after the conclusion of administrative and legal procedures.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b></p> <p>1. With purpose of providing more efficient services, to the citizens is made possible the transfer of files according to the residence.</p>	<p>kao i aktom o kupoprodaji Carinske službe Kosova. U ovim slučajevima, transakcije promene vlasništva snosi kupac –pobednik na aukciji koji je prethodno trebalo da ispuni obaveze u skladu sa stavom 1 ovog člana.</p> <p>4. Za vozila koja su odjavljena i za koja treba da se izvrši prenos vlasništva, čak i ukoliko kupac pripada drugoj opštini, pre svega treba da se ponovo registruje u postojećem OCRV-u a nakon toga treba da se prebaci u OCRV na osnovu mesta prebivališta građanina.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 13</b></p> <p>Motorna vozila koja su iz bilo kog razloga registrovana na neregularan način podležu procesu legalizacije, po okončanju administrativnih i pravnih postupaka.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b></p> <p>1. U cilju pružanja što efikasnijih usluga, građanima se omogućava prenos predmeta shodno mestu prebivališta.</p>
---	--	--



<p>2. Me rastin e transferimit të lëndëve, pala është e obliguar ti kthejë targat e automjetit në QKRA ku i ka marrë targat e fundit, poashtu DRA-në e anulon e njëjta QKRA. DRA-ja e anuluar i jipet pronarit i cili do ti drejtohet QKRA-së sipas vendqëndrimit apo vendbanimit, e cila do ta pajisë palën me DRA dhe targa të reja.</p>	<p>2. In the case of transfer of files, the party is obliged to return the vehicle plates to the MCVR where are taken the latest plates, also the DVR is annulled by the same MCVR. Annulled DVR is given to the owner who addresses the M CVR according to the residence or emplacement, and which will equip the party with DVR and new plates.</p>	<p>2. Prilikom prenosa predmeta, stranka je obavezna da vrati registarske tablice OCRV-u u kome je uzela poslednje tablice, a isti OCRV takođe poništava DRV. Poništeni DRV daje se vlasniku koji se obraća OCRV-u u skladu sa mestom boravka ili mestom prebivališta, koji će obezbediti stranki novi DRV i nove tablice.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15</b></p>
<p>1. Dhënia e targave provuese nuk nënkupton regjistrim të automjetit. Por, dhënia e targave provuese është mundësi për kyçje në komunikacionin rrugor për kohën e përcaktuar sipas këtij neni. Targat provuese mund të jepen për automjete motorike dhe bashkëngjitëse. Me rastin e dhënies së targave provuese, palës i lëshohet një Vërtetim nga DRAPSH-ja.</p>	<p>1. Giving of the probation plates does not mean the registration of vehicle. But, giving of probation plates is possibility for inclusion in the road traffic for a time determined by this article. Probation plates may be given for motorist vehicles and for trailers. In the case of giving probative plates an attestation is issued to the pair by DRVVD.</p>	<p>1. Davanje probnih tablica ne podrazumeva registraciju vozila. Međutim, davanje probnih tablica predstavlja mogućnost za uključivanje u drumski saobraćaj u periodu utvrđenom u skladu sa ovim članom. Probne tablice mogu se izdati za motorna i priključna vozila. Prilikom izdavanja probnih tablica stranku se uzdaje Potvrda od DVRDL.</p>
<p>2. Targat provuese jipen nga QKRA-ja, sipas kërkesës së pronarit të automjetit, në këto raste:</p>	<p>2. Probation plates are given by the MCVR on the request of the vehicle's owner, in these cases:</p>	<p>2. Probne tablice izdaje se od strane OCRV-a, na zahtev vlasnika vozila, u sledećim slučajevima:</p>
<p>2.1 Për automjetet e reja apo të përdorura me të cilat kryhet vozitja provuese;</p>	<p>2.1 For new or used vehicles by which is accomplished the probation drive;</p>	<p>2.1 Za nova ili korišćena vozila kojima se vrši probna vožnja;</p>
<p>2.2 Nga depoja e ndërmarrjes që i shet;</p>	<p>2.2 From the warehouse of the enterprise which is selling them;</p>	<p>2.2 Iz skladišta preduzeća koje ih prodaje;</p>



<p>2.3 Në panairë, auto sallone, dhe për agjentët e shitjes.</p> <p>3. Për lëshimin e targave provuese kërkohen këto dokumente:</p> <p>3.1 Dëshmia mbi pronësinë;</p> <p>3.2 Kërkesa për lejimin e targave provuese;</p> <p>3.3 Dëshmia mbi pagesën e taksave administrative;</p> <p>3.4 Pagesa e targave provuese;</p> <p>3.5 Dëshmia mbi pagesën e sigurimit ndaj palëve të treta.</p> <p>4. Me rastin e dhënies së targave provuese pronarit i lëshohet vërtetimi për shfrytëzimin e targave i cili përmban:</p> <p>4.1 Emrin dhe mbiemrin e poseduesit të automjetit;</p> <p>4.2 Qëllimi i përdorimit të automjetit;</p> <p>4.3 Lloji i automjetit, marka, modeli, numri i shasisë, ngjyra dhe afati i përdorimit të targave provuese.</p> <p>5. Targat provuese lëshohen me afat deri në 15 ditë, për automjetet e zhdoganuara .</p>	<p>2.3 In fairs, auto-shops, and for selling agents.</p> <p>3. For the issuance of the probation plates are required these documents:</p> <p>3.1 Evidence on ownership;</p> <p>3.2 Request for allowance of the probation plates;</p> <p>3.3 Proof on payment of administrative taxes;</p> <p>3.4 Payment of probation plates;</p> <p>3.5 Proof on the payment of insurance towards third persons.</p> <p>4. In the case of giving of probation plates to the owner is issued a certificate on use of plates which contains:</p> <p>4.1 Name and surname of the possessor of the vehicle;</p> <p>4.2 Purpose of use of the vehicle;</p> <p>4.3 Type of the vehicle, firm, type, chassis number, colour and timeframe of use of probation plates.</p> <p>5. Probation plates are issued in timeframe of up to 15 days for the de-customed vehicles.</p>	<p>2.3 Na sajmovima, u auto salonima i za agente prodaje.</p> <p>3. Sledeća dokumenta zahtevaju se za izdavanje probnih tablica:</p> <p>3.1 Dokaz o vlasništvu;</p> <p>3.2 Zahtev za dozvoljavanje probnih tablica;</p> <p>3.3 Dokaz o uplati administrativnih taksi;</p> <p>3.4 Uplata za probne tablice;</p> <p>3.5 Dokaz o plaćanju osiguranja trećih strana.</p> <p>4. Prilikom davanja probnih tablica, vlasniku se izdaje i potvrda o upotrebi tablica koja sadrži:</p> <p>4.1 Ime i prezime vlasnika motornog vozila,</p> <p>4.2 Svrhu upotrebe motornog vozila,</p> <p>4.3 Vrstu motornog vozila, marku, tip, broj šasijske, boju i rok upotrebe probnih tablica.</p> <p>5. Probne tablice izdaje se na rok od najviše 15 dana za ocarinjena motorna vozila.</p>
---	--	--





